

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria Austroterm GmbH., me seli në Peter Schmid-Gase 1, 7423, Pinkafeld, Austri, dorëzuar përmes avokates Andrea Lazarevska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 04.09.2024, mori këtë

### **AKTVENDIM**

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Austroterm GmbH., me seli në Peter Schmid-Gase 1, 7423, Pinkafeld, Austri do të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë Monosi-Siskevasia AVEE, me seli në Vrisses Vatheos Avlidos (70 km National road Athens-Lamia), 34100 Halkida, Greqi, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 24.07.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga Austroterm GmbH., me seli në Peter Schmid-Gase 1, 7423, Pinkafeld, Austri, me të cilin Austroterm GmbH. do të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë Monosi-Siskevasia AVEE, me seli në Vrisses Vatheos Avlidos (70 km National road Athens-Lamia), 34100 Halkida, Greqi.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-**Austroterm GmbH.** është kryesisht aktive në prodhimin dhe shitjen e materialeve izoluese të bëra nga polistireni i zgjeruar (EPS) dhe polistireni i ekstruduar (KSPS) që përdoren si

materiale izoluese për ndërtesa, por me fusha të ndryshme aplikimi. Portofoli i produkteve të Austroterm plotësohet me profile fasade dhe panele ndërtimi për veshjen e dysHEMEVE dhe mureve.

Austroterm GmbH është pjesë e Schmid Industrieholding GmbH, Austri ("SHIH"). Përmes shoqërive të lidhura të saj, SHIH është aktive në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë nxjerrjen e lëndëve të para (kryesisht nxjerrja e gëlqeres, talk); prodhimi i çimentos; materiale për industrinë e ndërtimit (si bojëra, produkte të parafabrikuara, veshje, llaçe, izolim, stuko, mbushës, tulla, çimento, industria e betonit); tregti, furra për ruajtje, industria e reklamave dhe pajisje gjuetie.

SHIH ka një filial të regjistruar në Maqedoninë e Veriut - shoqëria BAUMIT SHPKNJP Shkup, me seli në Rrugën e Adriatikut 165, Shkup, Maqedonia e Veriut, me veprimtari kryesore - tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve sanitare.

**-Monosi-Siskevasia AVEE** është një shoqëri greke e themeluar në vitin 1997 e cila merret kryesisht me prodhimin e produkteve EPS, përkatësisht pllaka izoluese dhe produkte për paketimin e ushqimeve dhe produkteve farmaceutike.

Në vitin 2001, Monosi-Siskevasia AVEE u zhvendos në një objekt të ri modern në rrugën kombëtare Athinë-Lamia. Ajo është shoqëria e parë të cilës shoqëria e njohur gjermane BASF i dha urdhër për prodhimin dhe marketingun e materialit inovativ NEOPOR në vitin 2003.

Viti 2001 shënoi fillimin e programit afatgjatë të investimeve të Monosi-Siskevasia AVEE, i cili përfshinte investime të vazhdueshme në pajisje makinerie kryesisht në sektorin e paketimit nga 2007-2010 dhe në fushën e izolimit nga 2004-2007. Nga viti 2014 deri në 2020 është bërë një investim i madh me blerjen e 2 makinave robotike për prerjen e pllakave termoizoluese si dhe një makinë tjetër për prodhimin e blloqeve për shërbim edhe më të shpejtë të klientëve të shoqërisë.

Monosi-Siskevasia AVEE nuk ka ndërmarrje të varura, aktivitete ose të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Transaksioni i propozuar i referohet tregut për prodhimin dhe shitjen e materialeve izoluese EPS.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**KRYETARE**

**Ана Николоска**